

	<p>Ngarkimi , faturimi dhe kontestet e faturimit</p>	<p>PR-MO-005</p>
	<p><i>ver. 1.0</i></p>	<p><i>page 1 from 17</i></p>
<p><i>Departamenti: Operimi i Tregut</i></p>		<p><i>Sektori:Barazimi Përfundimtar</i></p>

Ngarkimi, Faturimi dhe Kontestet e Faturimit

	Ngarkimi , faturimi dhe kontestet e faturimit	PR-MO-005
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 2 from 17</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori:Barazimi Përfundimtar</i>

PËRMBAJTJA

1.	QËLLIMI.....	3
2.	FUSHA.....	3
3.	PALËT PËRGJEGJËSE DHE PËRDORUESIT	4
4.	PËRMBLEDHJE	5
5.	PËRMBLEDHJA E PROCEDURËS.....	10
1.1.	Parakushtet	10
1.2.	Dispozitat e përgjithshme.....	10
6.	PËRMBLEDHJA E PROCEDURËS: FATURIMI I GJENERIMIT DHE FURNIZIMI.....	11
1.1.	Barazimi dhe Faturimi për HC Ujmani	11
1.2.	Barazimi dhe Faturimi për Kosova A.....	12
1.3.	Barazimi dhe Faturimi për Kosova B	12
1.4.	Barazimi dhe Faturimi për Centralin e Bashkëgjenerimit Kosova - Thëngjilli	12
1.5.	Barazimi dhe Faturimi për Gjenerimin e Ndërlidhur (HC Lumbardhi)	12
1.6.	Përmbledhje e Procedurës: Faturimi i Furnizimit.....	13
1.7.	Përmbledhja e Procedurës: Faturimi i Tregtive Balancuese Sekondare	13
7.	PËRMBLEDHJA E PROCEDURËS: BARAZIMI DHE FATURIMI I KAPACITETIT INTERKONEKTIV, IMPORTI DHE EKSPORTI I ENERGJISË..	13
7.1.	Faturimi i Kapacitetit të Kontraktuar Interkonektiv	13
7.2.	Importi dhe Eksporti i Energjisë	14
8.	PËRMBLEDHJA E PROCEDURËS: FATURIMI I TARIFAVE DIREKTE TË KOSTT DHE BORXHEVE.....	14
1.1.	Tarifat për Ofrimin e Rrjetit	14
1.2.	Tarifat për Menaxhimin e Sistemit	14
1.3.	Tarifat e Operatorit të Tregut	15
1.4.	Bashkërendimi i Humbjeve të Transmisionit.....	15
9.	PËRMBLEDHJA E PROCEDURËS: FATURIMI DHE KONTESTET E FATURAVE	15
9.1.	Menaxhimi i Reklamimeve të Faturave.....	15
10.	DOKUMENTET/FOMULARËT	17

	Ngarkimi , faturimi dhe kontestet e faturimit	PR-MO-005
	ver. 1.0	page 3 from 17
Departamenti: Operimi i Tregut		Spektori:Barazimi Përfundimtar

1. QËLLIMI

Kjo Procedurë Operative është e bazuar në dispozitat e Rregullave të Tregut të Kosovës dhe ofron informata se si do të procedohet kalkulimi i shumave të faturuara të energjisë/humbjeve bazuar në të Dhënat e Matjes. Për më tepër, ofron rregullat dhe përshkrimet se si duhet të kontestohen shumat e energjisë së faturuar / humbjeve të faturuara.

Prandaj, kjo i mundëson KOSTT në kapacitetin e vet si OT të përmbush përgjegjësitë e veta për faturimin e kostove të veta dhe të përmbush detyrat e veta për faturimin për palët e treta, si është definuar në Licencën për OT të nxjerrë nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë në tetor 2006 dhe në Rregullat e Tregut.

Termet specifike të përdorura në këtë procedurë janë të definuara në një dokument të veçantë “Fjalorthi i Procedurave Operative” i cili do të dorëzohet dhe publikohet së bashku me Procedurat. Termet të cilat tashmë janë të definuara në Rregullat e Tregut, Kodin e Rrjetit dhe Kodin e Matjes nuk do të definojnë në Fjalorthin e Procedurave Operative.

2. FUSHA


Kjo procedurë operative ofron udhëzime se si duhet të përdoren të Dhënat e Matjes të mbledhura sipas Procedurës Operative T101 për të kryer faturimin si në vijim:

Faturat e OT

- Tarifat Direkte dhe Detyrimet të cilat përfshijnë Tarifat për Mbështetje të Rrjetit të Transmisionit, Tarifat për Menaxhimin e Sistemit dhe Tarifat e OT

OT në kapacitetin e tij si Agjent i Faturimit

- Gjenerimi i Energjisë:
 - KEK Gjenerimi për KEK Furnizimin
 - Ujmani për KEK Furnizimin
 - Lumbardhi për KEK Furnizimin
- Humbjet e transmisionit
 - KEK Furnizimi për KOSTT
- Tarifat për Përdorimin e Sistemit të Shpërndarjes
 - Furnizuesi për OSSh
 - Konsumatorët e Kualifikuar në kapacitetin e vetë si vetë furnizues për OSSh
- Energjia e Furnizuar
 - KEK Furnizimi për konsumatorët e kualifikuar të lidhur në rrjetin e transmisionit

	Ngarkimi , faturimi dhe kontestet e faturimit	PR-MO-005
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 4 from 17</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori:Barazimi Përfundimtar</i>

- Bashkë gjenerimi Kosova thëngjilli për KEK Furnizimin
- Tregtarët interkonektiv
 - KEK furnizimi për transaksionet me Tregtarë për Importe/Eksporte

Kjo procedurë nuk mbulon çfarëdo faturimi ndërmjet KEK Shpërndarjes dhe KEK Furnizimit (DUoS); ose ndërmjet KEK Furnizimit dhe konsumatorëve të vet në Sistemin e Shpërndarjes.

3. PALËT PËRGJEGJËSE DHE PËRDORUESIT

Operatori i Tregut (OT)


- Zbaton këtë Procedurë Operative, përmirëson dhe azhurnon këtë Procedurë Operative varësisht nga modifikimet e legjislacionit primar dhe sekondar në Kosovë.
- Publikon dhe vë në dispozicion këtë Procedurë Operative për të gjitha Palët Tregtare
- Udhëheqë procesin e faturimit të Tregut sipas dispozitave të Rregullave të Tregut dhe kësaj Procedure Operative.
- Dërgon faturat të gjithë palëve të Tregut si definohet në këtë Procedurë Operative.
- Udhëheq procesin e reklamimit të faturave sipas dispozitave të Rregullave të Tregut dhe kësaj Procedure Operative.

Operatori i Sistemit (OST)

- Mirëmban Bazën e të Dhënave të Matjes së Operatorit të Tregut
- Ofron OT të Dhënat e Matjes të kalkuluara si duhet dhe të agreguara
- Përgjigjet ndaj kërkesave për qartësime nga dhe prej OT

KEK Furnizimi, KEK Gjenerimi, PPE dhe tregtarët

- Pranojnë kopjet e faturave të lëshuara nga KOSTT në kapacitetin e vet si OT (duke vepruar si Agjent Faturues për Palët e Treta) dhe për faturat e definuara në Rregullat e Tregut
- Verifikon faturat dhe paraqet Reklamimet e Faturave sipas nevojës

	Ngarkimi , faturimi dhe kontestet e faturimit	PR-MO-005
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 5 from 17</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori:Barazimi Përfundimtar</i>

4. PËRMBLEDHJE

Kjo Procedurë Operative ofron rregullat, afatet kohore dhe përgjegjësitë për Pjesëmarrësit e Tregut të ndikuar nga faturimi në pajtim me Rregullat e Tregut Kapitulli XV.


Kjo përfshinë:

- Tarifat për Mbështetjen e Rrjetit të Transmisionit
- Tarifa për Menaxhimin e Sistemit
- Tarifa për Operatorin e Tregut

Për më tepër, KOSTT në kapacitetin e vet si OT do të – bazuar në licencën e dhënë nga ZRrE – veproj si Agjent Faturues dhe prandaj do të përgatis dhe lëshoj faturat për Palët e Treta si në vijim:


- KEK Gjenerimi (Kosova A) (Kosova B)
- Prodhimi i Pavarur
- Konsumatorët e Kualifikuar të lidhur në rrjetin e transmisionit
- KEK Furnizimi (për humbjet e transmisionit)
- Krijoj një njoftim për Mosbalanc për Eksport/Import në Interkonektor për llogarinë e Mosbalancit të KEK
- KOSTT për Rregullimin Frekuencë-Fuqi.
- Pjesëmarrësit e Tregut, nënshkruesit e Marrëveshjes Kornizë për Rregullat e Tregut ose Marrëveshja për Aderim

Fotografia vijuese jep një përmbledhje të aktiviteteve të KOSTT duke vepruar si Agjent për Faturim në pajtim me licencën e OT.

	Ngarkimi , faturimi dhe kontestet e faturimit	PR-MO-005
	ver. 1.0	page 6 from 17
Departamenti: Operimi i Tregut		Sektori:Barazimi Përfundimtar



Financial Flows - Electricity Market



Bazuar në informatat e mbledhura në pajtim me procedurën operative T101 Mbledhja e të Dhënave të Matjes – KOSTT në kapacitetin e vet si OT do të përgatis dhe nxjerr disa lloje të faturave. Prandaj, nevojiten një mori të shkëmbimit të të dhënave dhe kalkulimeve. Tabela vijuese ofron një përmbledhje



Ngarkimi , faturimi dhe kontestet e faturimit

PR-MO-005

ver. 1.0

page 7 from 17

Departamenti: Operimi i Tregut

Sektori:Barazimi Përfundimtar

Agjenti i Faturimit për	Fillimi	Vëllimi	Humbjet	Çmimi	Koha	Fatura nga	Fatura për
KEK Gjenerimi për KEK Furnizimin	1 Maj 07	Shuma e gjenerimit të Kosovës A dhe B minus njësorët e ngarkesës së centralit	Vlerat e njehsorit përshtaten për kufirin e gjenerimit transmisionit (pajtuara)	Çmimi i Rregulluar si definohet nga ZRRrE	Dita e 15 e punës pas muajit Barazues	KEK Prodhimi	KEK Furnizimi
Ujmani për KEK Furnizimin	1 Maj 07	Njehsori i gjenerimit të Ujmanit për ngarkesën e centralit	Vlerat e njehsorit përshtaten për kufirin e gjenerimit transmisionit (pajtuara)	Çmimi i kontraktuar i miratuar nga ZRRrE	Dita e 15 e punës pas muajit Barazues	Ujmani	KEK Furnizimi
Bashkë gjenerimi Kosova thëngjilli për KEK Furnizimin	1 Maj 07	Njehsori i bashkëgjenerimit	Vlerat e njehsorit përshtaten për kufirin e gjenerimit transmisionit (pajtuara)	Çmimi i kontraktuar i miratuar nga ZRRrE	Dita e 15 e punës pas muajit Barazues	Bashkëgjenerimi thëngjilli	KEK Furnizimi
Lumbardhi (dhe të tjerët) për KEK Furnizimin	1 Maj 07	Njehsori i Gjenerimit minus ngarkesa e centralit	Vlerat e njehsorit përshtaten për kufirin e gjenerimit distribucionit (pajtuara)	Çmimi i kontraktuar i miratuar nga ZRRrE	Dita e 15 e punës pas muajit Barazues	Gjeneratori	KEK Furnizimi
KEK Furnizimi konsumatorët e kualifikuar të lidhur në rrjetin e transmisionit	1 Maj 07	Vëllimi (MWh) i ofruar në kufi minus njësorët e shpërndarjes për konsumatorët tjerë (nëse ka)	Vlerat e njehsorit përshtaten për kufirin e gjenerimit transmisionit (pajtuara)	Çmimi i kontraktuar i miratuar nga ZRRrE	Dita e 15 e punës pas muajit Barazues	KEK Furnizimi	Konsumatorët e lidhur në rrjetin
KEK Furnizimi për Importet	Koha e fillimit të tregtimit - KEK	Vëllimi MWh	Asnjë	Çmimi tregtar nga KEK	Me konfirmim e tregtisë dhe në ditën e 15 të Punës pas muajit Barazues	Gjeneratori / Tregtari	KEK Furnizimi
KEK Furnizimi për Eksportet	Koha e fillimit të tregtimit - KEK	Vëllimi MWh	Asnjë	Çmimi tregtar nga KEK	Me konfirmim e tregtisë dhe në ditën e 15 të Punës pas muajit Barazues	KEK Furnizimi	Gjeneratori / T



Ngarkimi , faturimi dhe kontestet e faturimit

PR-MO-005

ver. 1.0

page 8 from 17

Departamenti: Operimi i Tregut

Sektori:Barazimi Përfundimtar

Tarifat vetanake të KOSTT

Tipi i tarifës	Fillimi	Përfundimi	Vëllimi	Humbjet	Çmimi	Koha	Fatura nga	Fatura deri
Tarifat e Rrjetit të Transmisionit	1 Maj 07	31 Dhjet 08	Referohu Nenit 58 të Rregullave të Tregut	Referohu Nenit 61 të Rregullave të Tregut	Çmimi i rregulluar i definuar nga ZRrE	15 Ditë pas muajit Barazues	OT	Të gjitha
Tarifat për Menaxhimin e Sistemit	1 Maj 07	31 Dhjet 08	Referohu Nenit 59 të Rregullave të Tregut	Referohu Nenit 61 të Rregullave të Tregut	Çmimi i rregulluar i definuar nga ZRrE	15 Ditë pas muajit Barazues	OT	Të gjitha dhe Fatura
Tarifa për Operatorin e Sistemit	1 Maj 07	31 Dhjet 08	Referohu Nenit 60 të Rregullave të Tregut	Referohu Nenit 61 të Rregullave të Tregut	Çmimi i rregulluar i definuar nga ZRrE	15 Ditë pas muajit Barazues	OT	Të gjitha dhe Fatura
Tarifat për Ankandin e Interkoneksionit	Ankandi i parë i interkoneksionit në 2007	31 Dhjet 08	Rezultatet e Ankandit të Interkoneksionit	Nr.	Çmimi i Kliringut të Tregut si definohet në Ankand	15 Ditë pas muajit Barazues	OT	Pjesëmarrja e Ankandit të Interkoneksionit



	Ngarkimi , faturimi dhe kontestet e faturimit	PR-MO-005
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 9 from 17</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektor:Barazimi Përfundimtar</i>

Tabela vijuese jep një përmbledhje për hapat dhe planin kohor për faturim dhe kontestet e faturave:

Veprimet / Dokumentet	Pjesëmarrësi i Tregut D - Dërgon P - Pranon	OSD OST D - Dërgon P - Pranon	OT D - Dërgon P - Pranon	Plani kohor Ditë pune pas fundit të muajit Barazues
Përgatitja e Faturave në emër të KOSTT dhe në emër të Palëve të Treta	P	P	D	15
Koha e pagesës për të gjitha pagesat	D/P	P	P	22
Koha e lëshimit të Reklamimeve të Faturave	D		P	20
Koha për zgjidhjen e Reklamimeve (ose si duhet informimi nga ZRrE)	P	P	D	28

	Ngarkimi , faturimi dhe kontestet e faturimit	PR-MO-005
	ver. 1.0	page 10 from 17
Departamenti: Operimi i Tregut		Sektori:Barazimi Përfundimtar


5. PËRMBLEDHJA E PROCEDURËS

1.1. Parakushtet

- 5.1.1. KEK duhet të lidhë një marrëveshje me KOSTT si OST për përshtatjen e humbjeve për t'i aplikuar në njehsorët e ngarkesës së gjenerimit dhe centralit dhe jep vlerat në kufirin e gjenerimit dhe transmisionit.
- 5.1.2. KOSTT në funksionin e tij si OT do të pranoj informatat vijuese
- (a) Emrat dhe adresat e të gjitha palëve të faturës
 - (b) Të gjitha çmimet për kontratat e gjenerimit dhe konsumatorët e kualifikuar
 - (c) Të gjitha kalkulimet e faktorit të humbjes
- 5.1.3. ZRrE do të jap të gjitha çmimet e rregulluara që do të aplikohen
- 5.1.4. Palët vijuese do të ofrojnë të gjitha informatat, posaçërisht vlerat e njehsorëve, në formatin dhe frekuencën e definuar në Procedurën Operative T101.
- (a) KEK Gjenerimi
 - (b) KEK Furnizimi
 - (c) PPE
 - (d) Konsumatorët e kualifikuar

1.2. Dispozitat e përgjithshme

- 5.1.5. Mbledhja ose Zëvendësimi (ku është e nevojshme) dhe agregimi i të Dhënave të Njehsorëve duhet të bëhet si definohet në Procedurën Operative T101.
- 5.1.6. Pas nxjerrjes së Deklaratës së vëllimeve të Matura në Ditën e punës pas fundit të muajit barazues dhe prodhimit të një pro-forma fature në Ditën e 10 të Punës pas fundit të muajit barazues, OT do të lëshoj faturat në Ditën 15 të Punës pas fundit të muajit përkatës barazues.
- 5.1.7. OT do të lëshoj faturat për Pjesëmarrësit e Tregut në emër të KOSTT dhe Pjesëmarrësve të tjerë të Tregut sipas detyrës së tij si agjent faturues për palën e tretë.
- 5.1.8. Përgatitja dhe lëshimi i faturave duhet të ndërmerret nga OT për të gjitha faturat e përmendura në Rregullat e Tregut Neni 65.
- 5.1.9. Pjesëmarrësit e Tregut, ose OT si mund të jetë rasti, kanë 7 Ditë Pune për të paguar, pas datës kur fatura është dërguar nga OT, dmth. afati i pagesës për të gjitha faturat është 22 Ditë Pune pas fundit të muajit barazues.
- 5.1.10. Në rast se data e lëshimit nuk është e njëjtë me datën e pranimit, afati i pagesës është 7 Ditë Pune pas pranimit të faturës.

	Ngarkimi , faturimi dhe kontestet e faturimit	PR-MO-005
	ver. 1.0	page 11 from 17
Departamenti: Operimi i Tregut		Sektori: Barazimi Përfundimtar


- (a) Në rast se data e lëshimit nuk është e njëjtë me datën e pranimit, afati i pagesës është 7 Ditë Pune pas pranimit të faturës.
- 5.1.11. Në rast se OT vonohet në lëshimin e faturave, afati i pagesës është 7 Ditë të Punës pas pranimit të faturës.
- (b) Në rast se data e lëshimit nuk është e njëjtë me datën e pranimit, afati i pagesës është 7 Ditë Pune pas pranimit të faturës.
- 5.1.12. Një faturë duhet të përmbaj të dhënat sipas Nenit 68 të RrT dhe të dhënat tjera mbështetëse ku është e nevojshme.
- 5.1.13. Faturat duhet të lëshohen në formatin elektronik si dhe në letër të vulosura dhe të nënshkruara.
- 5.1.14. OT do të definoj formatin e faturave dhe dërgoj ZRrE formatin e faturës për shqyrtim dhe miratim.

Nëse Palët Tregtare pajtohen të paguajnë në planet kohore të ndryshme KOSTT do të ofroj faturat sipas planit kohor të pajtuar pas kërkesës me shkrim nga Palët Tregtare.

6. PËRMBLEDHJA E PROCEDURËS: FATURIMI I GJENERIMIT DHE FURNIZIMI

1.1. Barazimi dhe Faturimi për HC Ujmani

- 6.1.1. Barazimi duhet të bëhet bazuar vetëm në të Dhënat e Matjes të lexuara mekanikisht ose zëvendësimet e të Dhënave të Matjes të kalkuluara si definohet në Procedurën Operative T101.
- 6.1.2. Barazimi duhet të kryhet vetëm kur HC Ujmani të prodhoj energji elektrike gjatë muajit relevant të barazimit. Përcaktimi i faktorit të humbjeve të transformatorit ngritës duhet të aplikohet sepse njehsorët nuk janë të vendosur në kufirin komercial.
- 6.1.3. Përcaktimi i faktorëve të humbjes së transformatorit ngritës duhet të kalkulohet bazuar në energjinë mujore të matur të HC.
- 6.1.4. Faturimi i energjisë elektrike të prodhuar do të bëhet bazuar në gjenerimin e matur të zvogëluar për faktorin e humbjes së transformatorit ngritës.

	<p style="text-align: center;">Ngarkimi , faturimi dhe kontestet e faturimit</p>	<p style="text-align: center;">PR-MO-005</p>
	<p style="text-align: center;"><i>ver. 1.0</i></p>	<p style="text-align: center;"><i>page 12 from 17</i></p>
<p><i>Departamenti: Operimi i Tregut</i></p>		<p><i>Sektori:Barazimi Përfundimtar</i></p>

1.2. Barazimi dhe Faturimi për Kosova A

- 6.1.5. Barazimi duhet të bëhet bazuar vetëm në të Dhënat e Matjes të lexuara mekanikisht ose zëvendësimet e të Dhënave të Matjes të kalkuluara si definohet në Procedurën Operative T101. Përcaktimi i faktorëve të humbjeve të transformatorit ngritës duhet të aplikohet për të gjithë gjeneratorët përfshirë transformatorët për ngarkesën e termocentralit por duke përjashtuar transformatorët T13, T34, T35 dhe T45.
- 6.1.6. Përcaktimi i faktorëve të humbjes së transformatorit ngritës duhet të kalkulohet bazuar në energjinë mujore të matur të TC Kosova A.
- 6.1.7. Faturimi i energjisë elektrike të gjeneruar do të bazohet në Ngarkesën e Centralit të Gjenerimit kur ngarkesa e centralit i referohet të njëjtës nyje të transmisionit si shuma e gjeneruar.

1.3. Barazimi dhe Faturimi për Kosova B


- 6.1.8. Barazimi duhet të bëhet bazuar vetëm në të Dhënat e Matjes nga Sistemi DGC ose zëvendësimet e të Dhënave të Matjes të kalkuluara si definohet në Procedurën Operative T101.
- 6.1.9. Përcaktimi i faktorëve të humbjes së transformatorit ngritës duhet të kalkulohet bazuar në energjinë mujore të matur të TC Kosova B.
- 6.1.10. Faturimi i energjisë elektrike të gjeneruar do të bazohet në Ngarkesën e Centralit të Gjenerimit kur ngarkesa e centralit i referohet të njëjtës nyje të transmisionit si shuma e gjeneruar.

1.4. Barazimi dhe Faturimi për Centralin e Bashkëgjenerimit Kosova - Thëngjilli

- 6.1.11. Barazimi duhet të bëhet bazuar vetëm në të Dhënat e Matjes nga Sistemi DGC ose zëvendësimet e të Dhënave të Matjes të kalkuluara si definohet në Procedurën Operative T101.
- 6.1.12. Përcaktimi i faktorëve të humbjes së transformatorit ngritës duhet të kalkulohet bazuar në energjinë mujore të matur të Centralin e Bashkëgjenerimit Kosova Thëngjilli.
- 6.1.13. Faturimi i energjisë elektrike të gjeneruar do të bazohet në Ngarkesën e Centralit të Gjenerimit.

1.5. Barazimi dhe Faturimi për Gjenerimin e Ndërlidhur (HC Lumbardhi)

- 6.1.14. Barazimi duhet të kryhet bazuar në të dhënat e vëllimit të energjisë të dorëzuara nga KEK Furnizimi në baza mujore si definohet në Procedurën T101.

	Ngarkimi , faturimi dhe kontestet e faturimit	PR-MO-005
	ver. 1.0	page 13 from 17
Departamenti: Operimi i Tregut		Sektori: Barazimi Përfundimtar

- 6.1.15. Faktorët e humbjeve duhet të kalkuloohen bazuar në energjinë mujore të matur të energjisë së gjenerimit të ndërlidhur.
- 6.1.16. Faturimi i energjisë elektrike të gjeneruar do të bazohet në Ngarkesën e Centralit të Gjenerimit kur ngarkesa e centralit i referohet të njëjtës nyje të shpërndarjes si shumta e gjeneruar.

1.6. Përmbledhje e Procedurës: Faturimi i Furnizimit

- 6.1.17. Faturimi i furnizimit gjatë fazës tranzicionale mbulon vetëm Konsumatorët e Kualifikuar të lidhur drejtpërdrejtë me rrjetin e transmissioinit (p.sh. Feronikeli (Alferoni), Sharrcem).
- 6.1.18. Barazimi duhet të kryhet bazuar në leximet mujore të njehsorëve të dorëzuara në baza mujore konsumatorëve të kualifikuar (për shembull Feronkeli), si definohet në Procedurën T101. Ku njehsorët nuk janë të vendosur në kufi faktori i vlerësuar i humbjeve do të konsiderohet (psh linjat nr.2299 dhe nr.2300).
- 6.1.19. Faturimi i energjisë elektrike të furnizuar do të bazohet në Energjinë e Matur.


1.7. Përmbledhja e Procedurës: Faturimi i Tregtive Balancuese Sekondare

- 6.1.20. KOSTT në kapacitetin e vet si OT do të përcjellë çfarëdo fature nga OST fqinje për Tregtitë Balancuese për KEK Furnizimin.

7. PËRMBLEDHJA E PROCEDURËS: BARAZIMI DHE FATURIMI I KAPACITETIT INTERKONEKTIV, IMPORTI DHE EKSPORTI I ENERGIJË

7.1. Faturimi i Kapacitetit të Kontraktuar Interkonektiv

- 7.1.1. KOSTT në kapacitetin e vet si OT do të përgatis një format të faturës për faturimin e Kapacitetit Interkonektiv të kontraktuar në Ankandet për Interkonektor sipas Procedurës Operative T201 dhe do t'ia paraqes këtë formë ZRrE për shqyrtim dhe miratim.
- 7.1.2. KOSTT në kapacitetin e vet si OT do të ofroj faturën për Kapacitetin e Kontraktuar Interkonektiv të kontraktuar në Ankandet për Interkonektor në Ditën e 2 të Punës pas ankandit të Interkonektorit.
- 7.1.3. Marrja e kapacitetit interkonektiv do të kalkulohet bazuar në formulën vijuese:
 - a) [çmimi i ankandit për Linjën Interkonektive të shumëzuar me Kapacitetin Interkonektiv] (1+ Shkalla e Tatimit)
- 7.1.4. Pjesëmarrësit e Tregut duhet të paguajnë faturat e lëshuara nga KOSTT sipas 7.1.2 brenda 7 Ditëve të Punës pas paranimimit të faturës.

	Ngarkimi , faturimi dhe kontestet e faturimit	PR-MO-005
	ver. 1.0	page 14 from 17
Departamenti: Operimi i Tregut		Sektori: Barazimi Përfundimtar

7.2. Importi dhe Eksporti i Energjisë

- 7.2.1. Të Dhënat e Matjeve për kalkulimin e energjisë së importuar dhe për kalkulimin e energjisë së eksportuar duhet të mblidhen dhe agregohen sipas dispozitave të Procedurës Operative T101.
- 7.2.2. Barazimi i energjisë së importuar nëpërmjet linjave interkonektive do të kalkulohet bazuar në:
- a) Çmimin tregtar të dorëzuar nga KEK bazuar në kontratat ndërmjet KEK dhe pjesëmarrësit tjerë të tregut
 - b) Energjia e Tregtuar e bazuar në vëllimet e deklaruara të tregtisë nga KEK dhe të konfirmuara nga pala tjetër (pjesëmarrësi i tregut).
- 7.2.3. Barazimi i energjisë së eksportuar nëpërmjet linjave interkonektive do të kalkulohet bazuar në:
- a) Çmimin tregtar të dorëzuar nga KEK bazuar në kontratat ndërmjet KEK dhe pjesëmarrësit tjerë të tregut
 - b) Energjia e Tregtuar e bazuar në vëllimet e deklaruara të tregtisë nga KEK dhe të konfirmuara nga pala tjetër (pjesëmarrësi i tregut).
- 7.2.4. Faturimi do të bëhet në baza mujore dhe për secilën palë të pjesëmarrësve.


8. PËRMBLEDHJA E PROCEDURËS: FATURIMI I TARIFAVE DIREKTE TË KOSTT DHE BORXHEVE

1.1. Tarifat për Ofrimin e Rrjetit

- 8.1.1. Tarifat e Rrjetit të Transmisionit do të kalkuloohen si definohet në Rregullat e Tregut, Neni 58 bazuar në tarifën e miratuar nga ZRrE.

1.2. Tarifat për Menaxhimin e Sistemit

- 8.1.2. Tarifat për Menaxhimin e Sistemit do të kalkuloohen si definohet në Rregullat e Tregut, Neni 59 dhe bazuar në tarifën e miratuar nga ZRrE.

	Ngarkimi , faturimi dhe kontestet e faturimit	PR-MO-005
	ver. 1.0	page 15 from 17
Departamenti: Operimi i Tregut		Sektori:Barazimi Përfundimtar

1.3. Tarifat e Operatorit të Tregut

- 8.1.3. Baza Tarifore e Operatorit të Tregut do të kalkulohet si definohet në Rregullat e Tregut, Neni 60, bazuar në tarifën e miratuar nga ZRrE.
- 8.1.4. Tarifa e Operatorit të Tregut për Gjenerator do të kalkulohet si definohet në Rregullat e Tregut, Neni 60, dhe bazuar në tarifën e miratuar nga ZRrE.
- 8.1.5. Tarifa e Operatorit të Tregut për Furnizuesin do të kalkulohet bazuar në Rregullat e Tregut, Neni 60 dhe bazuar në tarifën e miratuar nga ZRrE.


1.4. Bashkërendimi i Humbjeve të Transmisionit

- 8.1.6. Tarifa e Humbjeve të Transmisionit do të kalkulohet si vëllim i Përgjithshëm mujor i humbjeve të transmisionit shumëzuar me çmimin e rregulluar (sipas çmimit më të fundit të ZRrE) për humbjet.


9. PËRMBLEDHJA E PROCEDURËS: FATURIMI DHE KONTESTET E FATURAVE

9.1. Menaxhimi i Reklamimeve të Faturave

- 9.1.1. Nëse një Pjesëmarrës i Tregut paraqet një Reklamimin të Faturës bazuar në Nenin 67.4 të Rregullave të Tregut duhet të konsiderohen dispozitat vijuese:
- (a) Shuma e pakontestuar e faturës është e pagueshme në të gjitha rastet në afatin e pagesës si definohet në paragrafin 5.2.5.
 - (b) normat e interesit për shumën e kontestuar e cila më vonë përcaktohet të jetë e saktë është normë ditore bazuar në normën vjetore prej 4.5% në vit, ndërmjet afatit të pagesës së faturës dhe datës së zgjidhjes.
 - (c) Në rast të kalkulimeve të pa sakta sipas 9.1.7, interesi i paguar për pjesëmarrësin e tregut për shumën e kontestuar do të jetë 4.5%.
- 9.1.2. Norma e interesit për të gjitha pagesat e vonuara është 8% p.a. të shumës së vonuar
- 9.1.3. Pjesëmarrësi i Tregut i cili paraqet një Reklamim të Faturës duhet të dorëzoj një njoftim me shkrim OT duke identifikuar:
- (a) DI të faturës relevante
 - (b) Vijën e kontestuar të faturës
 - (c) Një shpjegim për arsyet e paraqitjes së Reklamimit të Faturës.
- 9.1.4. Reklamimi i Faturës duhet t'i dërgohet OT jo më vonë se 5 Ditë Pune pas pranimit të faturës përkatëse. Paralelisht, nëse Reklamimi i Faturës nuk mund të zgjidhet menjëherë, një njoftim për kontestin duhet t'i dërgohet palës së ndikuar.

	<p>Ngarkimi , faturimi dhe kontestet e faturimit</p>	<p>PR-MO-005</p>
	<p>ver. 1.0</p>	<p>page 16 from 17</p>
<p>Departamenti: Operimi i Tregut</p>		<p>Spektori:Barazimi Përfundimtar</p>

- 9.1.5. Në rast se Reklamimi i Faturës bazohet në një reklamim të pazgjdhur të të dhënave të matjeve sipas T101 ky fakt duhet të shënohet në njoftimin për Reklamimin e Faturës.
- 9.1.6. OT menjëherë duhet të kontrolloj Reklamimin e Faturës dhe nëse paraqitet kontesti, duhet të njoftoj Pjesëmarrësin relevant të Tregut për vendimin e OT sa më parë që është e mundur, por jo më vonë se 5 Ditë Pune pas pranimin të Reklamimit të Faturës.
- 9.1.7. Nëse një faturë duhet të përmirësohet për shkak të gabimeve në kalkulim nga OT, OT do të përgatis një faturë të re për shumën e kontestuar dhe do të lëshoj faturën e përmirësuar jo më vonë se 10 Ditë Pune pas pranimin të Reklamimit të Faturës.
- 9.1.8. Nëse shuma e kontestuar është kalkuluar saktë, nuk nevojitet veprim i mëtutjeshëm.
- 9.1.9. Nëse një kontest i faturës nuk mund të zgjidhet ndërmjet OT dhe Pjesëmarrësit të Tregut i cili ka paraqitur kontestin brenda 20 dite nga data e lëshimit të faturës përkatëse, OT do të njoftoj ZRrE për këtë.

	Ngarkimi , faturimi dhe kontestet e faturimit	PR-MO-005
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 17 from 17</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori:Barazimi Përfundimtar</i>

10. DOKUMENTET/FORMULARËT

Burimet

Nr.	Emri i dokumentit
1	Rregullat e Tregut
2	Licenca e Operatorit të Tregut

Dokumentet/formularët

- Fatura
- Parafatura

Shënimet për versionet

Versioni	Data	Përshkrimi	Kohëruajtja
1.0	Janar 2008	Verzioni inicial	5 vite